



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 194, Datë 13.07.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“GERTI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/1 prot., datë 10.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, pika 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, gërmat “a” “c” dhe “d”; pika 1.3, gërma “a”.
- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- ❖ *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
 - **gërma “b”**: dëshminë e penaltetit për administratorin tjetër të saj.
- ❖ *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
 - **gërma “b”**: informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë për 5 vitet e ardhme të ushtrimit të aktivitetit, përlllogaritjen për vlerën që nevojitet për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 (një) muaj dhe mbështetjen financiare.
 - **gërma “c”**: Planin e Biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) -vjeçar.
2. Shoqëria “GERTI” sh.p.k., të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

